



Nr. 58 Viti i gjashtë i botimit Mars 2018

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- 2 Shkurti, Dita Botërore e Ligatinave
- Vlerësimi, Analizimi dhe Hartëzimi i impakteve negative në Zonat e Mbrojtura
- Vlerësimi i gjendjes së Mjedisit Detar në Shqipëri
- Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?
- Vlerësimi i performancës së energjisë në ndërtesa, Risi e projektit "Së bashku një sy për mjedisin" / Nga Qendra EDEN
- Njoftime

... me këtë rast Ju kujtojmë se
58 vjet më parë ...

...me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.82, datë 02.03.2000 shpallet Park Kombëtar, në mbrojtje të shtetit, zona arkeologjike e Butrintit, me sipërfaqe 25 km².

Bazuar në rekomandimet e disa studime të kryera për këtë territor, kompleksi natyror ligatinor i Liqenit të Butrintit dhe rrethinat e tij, përfshihet edhe kepin e Stillosë, me VKM nr.693, datë 10.11.2005, u rishpall Park Kombëtar,

me sipërfaqe të zgjeruar prej 8,591.2 ha. Në kuadrin e projektit të Menaxhimit të Integruar dhe Pastrimit të Zonës Bregdetare (ICZMCP), u hartua dhe plani i menaxhimit të PK të Butrintit, i cili u miratua, sipas dispozitave të ligjit "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, me urdhrin nr.404, datë 09.06.2011 të ministrit të Mjedisit. Mbi bazën e rekomandimeve të planit të menaxhimit, me VKM nr.134, datë 20.02.2013, sipërfaqja e parkut u zgjeruar në 9,424.4 ha, nga e cila 883.2 ha është zonë detare.

Vijon në faqe 2



Vijon nga faqe 1 Territori natyror i kompleksit ligatinor të Butrintit (ku u përfshinë Liqeni i Butrintit, zona arkeologjike e PK të Butrintit, Kepi i Stilloe dhe ishujt e Keamillit), me sipërfaqe të përgjithshme prej 13,500 ha, me VKM nr.531, datë 31.10.2002, shpallet zonë natyrore, veçanërisht e mbrojtur, për t'u përfshirë në listën e Konventës (Ramsar) "Për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitate të shpendëve ujorë".

...9 vjet më parë ...

...me VKM nr.241, datë 06.03.2009 miratohet "Lista e llojeve të huaja invazive dhe për përcaktimin e procedurave, për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në pikat doganore të vendit". Sipas këtij vendimi...Ndalohet futja në territorin e Republikës së Shqipërisë të llojeve të huaja invazive, sipas përcaktimit të shtojcës I... Ndalimin e futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të ekzemplarëve të rinj, të llojeve të huaja, me shkallë invazioni 3, sipas shtojcës II...Lejimin ose ndalimin, për rastet e tjera, të një lloji të huaj, për t'u importuar ose për t'u introduktuar në territorin e vendit tonë, mbështetur në vlerësimin e rrezikut, që mbart importimi ose introduktimi i tij, i cili vlerëson shkallën e invazionit të llojit të huaj...Vlerësimi i rrezikut të një lloji të hua është vlerësimi i pasojave të introduktimit dhe mundësisë së instalimit të njëlloji të huaj, duke përdorur informacionin shkencor. Menaxhimi i rrezikut përcakton masat, që duhen zbatuar për t'i reduktuar ose menaxhuar rreziqet e identifikuar gjatë vlerësimit të rrezikut... Mos lejimin, nga administrata doganore, e futjes, në territorin doganor, të llojeve të huaja, kur subjektet nuk janë të pajisura me leje....etj...

...8 vjet më parë ...

...miratohet Ligji nr.10253, datë 11.03.2010 "Për gjuetinë". Ky ligj ka për qëllim: a) përcaktimin e rregullave e të kërkesave për zhvillimin e gjuetisë, si një veprimtar tradicionale, sportive, çlodhëse dhe turistike; b) menaxhimin e qëndrueshëm të gjuetisë, duke e vlerësuar faunën e egër si pasuri kombëtare që administrohet dhe mbrohet me ligj; c) garantimin që parimet për gjuetinë të zbatohen në mënyrë rigorozë, duke ruajtur tërësinë e ekosistemit dhe baraspeshën ekologjike; ç) mosdëmtimin e llojeve të faunës së egër e të habitateve të tyre gjatë ushtrimit të gjuetisë; d) respektimin e së drejtës së gjuetisë dhe të të drejtave mbi gjahun, mbi trofetë e produktet e gjuetisë dhe të tregtimit të tyre...

Me ligjin nr.7/2014 "Shpallet Moratoriumi i Gjuetisë në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i ligjit është përmirësimi i gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie. Ndërsa objekti i tij është ndalimi i ushtrimit të gjuetisë në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

AKZM me strukturat e saj të vartësisë, ka detyrë dhe duhet të jetë e kujdesshme që të evidentojnë dhe të marrin masa për kremtimin me dinjitet të këtyre datave historike, duke hapur një faqe të re në punën e tyre, për njohjen dhe promovimin e zonave të mbrojtura, duke bashkëpunuar ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.

INCA është e gatshme që të ndihmojë për promovimin e vlerave të natyrës e të biodiversitetit, në ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura dhe në hartimin e historisë së zonave të mbrojtura të Shqipërisë.

Ligatinat urbane i japin qyteteve gjallëri



**Dita
Botërore e Ligatinave**
2 Shkurt 2018

Ligatinat kontribuojnë në të ardhmen e qëndrueshme urbane



2 Shkurti, Dita Botërore e Ligatinave

2 Shkurti i çdo viti është shpallur si “Dita Botërore e Ligatinave”; kjo ditë shënon datën e miratimit të Konventës për Ligatinat në 2 Shkurt 1971 në qytetin Iranian të Ramsar-it. Ligatinat ose sistemet e “tokave të lagura”, janë sipërfaqe ujore të përhershme ose përkohshme deri në 6 metra thellësi, dhe përbëjnë një ekosistem mjaft të rëndësishëm që siguron larmi përfitimesh përfshirë filtrimin e ujit, sigurimin e biodiversitetit, mbrojtjen e bregdetit dhe zbutjen e ndryshimeve klimatike. Slogani i këtij viti është “Ligatinat kontribuojnë në të ardhmen e qëndrueshme urbane”.

Publiku i gjerë është pak i ndërgjegjshëm mbi shërbimet e rëndësishme të ligatinave. Shumë pak vetë e dinë se në vendin tonë 3% sipërfaqes së tokave të lagura në bregdet, strehojnë 75% të vlerave të biodiversitetit. Në jo pak raste, ligatinat janë shndërruar në vende për hedhjen e mbeturinave apo janë transformuar në toka buke apo terrene ndërtimi.

Dita Botërore e Ligatinave është një mundësi e mirë për të kërkuar ndryshimin e situatës dhe ndërgjegjësuar publikun mbi rëndësinë që kanë ligatinat për të ardhmen e njerëzimit.



SENIOR II
Mbështetje për Organizatat Mjedisore
në Shqipëri dhe Civile në Shqipëri

INCA
INSTITUTE FOR NATURE
CONSERVATION IN ALBANIA

RRJETI PËR
MBROJTJEN
E NATYRËS

Dita Botërore e Ligatinave

2 Shkurt

Ligatinat urbane i japin qyteteve gjallëri

Ligatinat kontribuojnë në të ardhmen e qëndrueshme urbane

PROMOVIMI DHE ADRESIMI I PËRDORIMIT TË QËNDRUESHËM
TË BURIMEVE DHE VLERAVE NATYRORE NË PARKUN KOMBËTAR
DIVJAKË-KARAVASTA

#KeepUrbanWetlands
#WorldWetlandsDay
www.worldwetlandsday.org

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

I.C.L.E.I
Local
Governments
for Sustainability

WWF

WWT

World
Wetlands Day
2 February 2018
Wetlands for a sustainable urban future

evian

Ramsar
Convention
on Wetlands

REC
2018

Suedi
Sverige

Vlerësimi, Analizimi dhe Hartëzimi i impakteve negative në Zonat e Mbrojtura

Tiranë - 16 Shkurt 2018 - Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA), në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit (REC Shqipëri), organizuan konferencën kombëtare, me rastin e përfundimit të fazes së parë të projektit "Promovimi dhe advokimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në Zonat e Mbrojtura", në kuadër të programit SENIOR-II, i cili zbatohet nga REC Shqipëri, me financim të Qeverisë Suedeze, Embassy of Sweden in Tirana.

Në këtë event përmbyllës morën pjesë dhe përshëndetën z. Mihallaq Qirjo (Drejtor Ekzekutiv i REC) dhe z. Zamir Dedej (Drejtor i Përgjithshëm i AKZM). Gjithashtu, ishin të pranishëm edhe mjaft organizata OMSHC-ve, në nivel kombëtar dhe lokal, si pjesëmarrës të këtij forumi kombëtar. Eventi kishte qëllim të ndante me aktorët kryesor rezultatet përfundimtare të procesit të vlerësimit, analizimit dhe hartëzimit e veprimtative me impact negative në 16 Zona të Mbrojtura në Shqipëri, për periudhën Maj 2017-Janar 2018.


Qëllimi dhe objektivat e dokumentit strategjik të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës ndjekin ato të programit SENIOR-II, duke u bazuar në parimet udhëheqëse të tij. Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe ZMM në vendin tonë vazhdon të përballet me problematika nga më të ndryshme, që vijnë nga aktivitetet dhe indiferenca njerëzore. Mos përfshirja e komunitetit dhe OSHC-ve në proceset e bashkëmenaxhimit dhe ato të vendimmarrjes është një mangësi që vjen përgjithësisht si rrjedhojë e kapaciteteve të ulëta, mungesës së njohurive në grupet e komunitetit lokal dhe të moskoordinimit midis organizatave të shoqërisë

civile që i përfaqësojnë. Nga ana tjetër komunitetet lokale nuk janë të mirë informuara mbi aktivitetet me impakt negativ në lokalitetet e tyre dhe mundësitë e përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore si potenciale për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre. Aktualisht, kjo situatë pengon zbatimin efektiv të politikave të ruajtjes së mjedisit dhe natyrës, duke sjellë menaxhim jo të mirë të burimeve natyrore.

Objektivi përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në menaxhimin e qëndrueshëm të ZMM, nëpërmjet forcimit të rolit aktiv dhe pjesëmarrës të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile. Nëpërmjet këtij projekti synohet fuqizimi i rolit dhe kapaciteteve teknike të anëtarëve të rrjetit për identifikimin dhe reagimin ndaj problematikave dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimarrëse për menaxhimin e ZMM. Projekti mundëson vlerësimin e nevojave dhe nxitjen e një bashkëpunimi sa më efektiv mes shoqërisë civile dhe strukturave ligjzbatues të fushës së natyrës në nivel

qendror si MTM dhe AKZM, dhe në nivel lokal AdRZM-të dhe pushteti vendor, si dhe partneritetin mes tyre në iniciativa të përbashkëta dhe aktivitete që kanë për qëllim adresimin dhe minimizimin e problemeve si dhe promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe promovimin e vlerave të biodiversitetit

Objektivat specifike të projektit janë: (i) Fuqizimi i rolit veprues të OMSHC-ve në identifikimin dhe reagimin ndaj çështjeve kritike me të cilat përballen ZM; (ii) Inkurajimi i rolit pjesëmarrës të OMSHC-ve si në vendimmarrje ashtu edhe në ndarjen e përfitimeve në menaxhimin e qëndrueshëm të ZMM.



Vijon nga faqe 3 Vlerësimi, analizimi dhe hartëzimi i veprimtative me impakt negativ në Zona të Mbrojtura Mjedisore të përzgjedhura u krye nga



INCA dhe OMSHC-të: “Forumi Shqiptar i Liqenit të Shkodrës”, Shkodër; “Mbrojtja dhe Zhvillimi Social-ILIRIA”, Tiranë; “Mbrojtja e Mjedisit dhe Zhvillimi i Turizmit”, Kukës; Shoqata “Miqësia”, Ulëz; “Mbrojtja e Natyrës dhe Administrimi i Mjedisit-Adriatik”, Vlorë; “Green and Clean”, Korçë dhe “Shoqata Mjedisore Çajupi”, Gjirokastër).

Në strategjinë e hartuar për Rrjetin e Mbrojtjes së Natyrës “Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura”, synohet një përfaqëje strategjike në adresimin afatgjatë të problematikës dhe të nevojave të rrjetit si dhe ngritja dhe zhvillimi i një sistemi për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen 16 Zona të Mbrojtura Mjedisore (ZMM) të përzgjedhura në rajonet: Tiranë, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, Mat, Durrës, Kukës, Shkodër, Elbasan dhe Fier.

Nëpërmjet projektit “Promovimi dhe adresimi i



menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura”, u synua aplikimi i një procesi vlerësimi për grumbullimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha aktivitetet me impakt negativ brenda territorit në zonat e mbrojtura të përzgjedhura, duke përdorur metodologjinë e pyetësorëve individual, takimet dhe bashkëbisedimet me komunitetin dhe palët e tjera të interesuara për përdorimin e burimeve natyrore dhe mirëmenaxhmin e ZMM si dhe mjaft dokumente, programe, raporte, plane menaxhimi etj, në lidhje me këtë fushë.

Vlerësimi dhe hartëzimi i impakteve negative u krye në zonat e mbrojtura mjedisore:

1. Parku Kombëtar “Divjakë-Karavasta”,
2. Parku Kombëtar “Shebenik-Jabllanicë”,
3. Parku Kombëtar “Lugina e Valbonës”,
4. Parku Kombëtar “Llogara” & Rezervati Natyror i Menaxhuar “Karaburun”,
5. Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”,
6. Parku Kombëtar “Prespa”,



7. Parku Kombëtar “Bredhi i Drenovës”,
8. Parku Kombëtar “Mali i Dajtit”,
9. Parku Kombëtar “Qafë Shtamë”,
10. Monumenti i Natyrës “Bredhi i Sotirës”,
11. Rezervati Natyror i Menaxhuar “Liqeni i Shkodrës”,
12. Parku Natyror “Korab-Koritnik”,
13. Parku Natyror Rajonal “Liqeni i Ulzës”,
14. Peizazhi i Mbrojtur “Lumi i Bunës-Velipojë”,
15. Peizazhi i Mbrojtur “Mali me Gropa-Bizë-Martanesh” dhe
16. Peizazhi i Mbrojtur “Vjosë-Nartë”.

Rrjeti i zonave të mbrojtura mjedisore, i marrë në studim, ka një shtrirje përfaqësuese të Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura Mjedisore (RrKZMM), me sipërfaqe

Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 4 të përgjithshme 318,275.1 ha, ose 65.36% të sipërfaqes së përgjithshme të rrjetit të zonave të mbrojtura të Shqipërisë, prej 487,000 ha.

Zonat e mbrojtura mjedisore të përzgjedhura përfaqësohet nga 9 parqe kombëtare, me sipërfaqe 159,875.9 ha; 2 rezervate natyror të menaxhuar/park natyror, me sipërfaqe 81,421.8 ha; 1 monument natyre, me sipërfaqe 1,740.0 ha, 3 peizazhe të mbrojtur, me sipërfaqe 71,031.4 ha dhe 1 park rajonal bashkiak me sipërfaqe 4,206.0 ha.

Projekti mundëson ngritjen e kapaciteteve të 30 organizatave pjesëmarrëse për identifikimin e problematikave kryesore me të cilat përballen sot ZMM. Për këtë qëllim INCA, si lider i RrMN, hartoi një metodologji për mënyrën e grumbullimit (pyetësor-individual) dhe më pas analizimin e informacionit faktik dhe real mbi të gjitha aktivitetet me impakt negativ brenda territorit në zona pilote të mbrojtura. Ngritja e kapaciteteve u shoqërua me organizimi i tre seminareve rajonale (Librazhd, Shkodër dhe Gjirokastrë) me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të RrMN, të OJF të përzgjedhura dhe AdRZM për njohjen dhe interpretimin e dispozitave dhe akteve nënligjore në fuqi për ruajtjen e natyrës si dhe kryerjen e procesit të vlerësimit dhe identifikimit të problematikave. Po kështu u organizuan edhe tre seminareve rajonale (Kukës, Vlorë dhe Prespë) për njohjen dhe zbatimin e metodologjisë për grumbullimin e të dhënave dhe plotësimin e pyetësorëve-individual.



Për identifikimin dhe vlerësimin e problematikave, nga secila organizatë e RrMN, u angazhuan grupe të vogla lokale me përfaqësues nga shoqëria civile dhe komunitetit

pranë ZMM. Në këtë kuadër u trajnuan rreth 390 pjesëmarrës nga OMSHC-të (pjesë e RrMN) dhe OJF-t mjedisore të përzgjedhura.



Impaktet u identifikuan në kuadër të bashkëbisedimeve me grupet e interesit, anketimeve individuale (plotësimi i pyetësorit), në këshillim me dispozitat ligjore në fuqi për fushën e ruajtjes së natyrës dhe të zonave të mbrojtura, programet, planet e menaxhimit, raportet e mbi gjendjen e mjedisit, të studimeve të ndryshme etj, sëbashku me organizatat partneretë OJF-ve lokale dhe Administratat e Zonave të Mbrojtura Mjedisore, në nivel qarku. Bazuar mbi gjetjet dhe faktet e grumbulluara u hartua dhe raporti vlerësim-analizë-hartografim. Në fund të këtij investigimi INCA përgatiti hartëzimin e aktiviteve me efekte negative në 16 ZMM e përfshira në studim. Njëherazi projekti mundëson vlerësimin e nevojave dhe nxitjen e një bashkëpunimi sa më efektiv mes shoqërisë civile dhe strukturave ligjzbatues të fushës së natyrës, në nivel qendror si Ministria e Turizimit dhe Mjedisit (MTM) dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), dhe në nivel lokal Administratat Rajonale të Zonave të Mbrojtura (AdRZM) dhe pushteti vendor, si dhe partneritetin mes tyre në iniciativa të përbashkëta dhe aktivitete që kanë për qëllim adresimin dhe minimizimin e problemeve negative.

Gjithashtu, synimi kryesor i strategjisë së rrjetit për mbrojtjen e natyrës është të forcojë më tej kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile të Shqipërisë, pjesëtare të rrjetit, që të jenë të afta të luajnë rolin e katalizatorit, për të garantuar pjesëmarrjen sa më të

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5

gjerë proaktive të komuniteteve lokale si në vendimmarrje ashtu dhe në ndarjen e përfitimeve që vijnë nga menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore duke kontribuar njëkohësisht në ruajtjen dhe promovimin e vlerave të larta të biodiversitetit që karakterizojnë natyrën shqiptare.

Pra, në fazën e parë të zbatimit të projektit, efida në fushën e mbrojtjes së natyrës, u fokusuar në krijimin e një ekspertize të mirë për të përmbushur qëllimin kryesor dhe objektivat specifike të projektit. Ky projekt, nëpërmjet bashkëbisedimeve me palët e interesuar dhe me aplikimin e një metodologjie (pyetësor-individual) efektive, identifikoi dhe trajtoi, në përgjithësi dhe veçanti, mangësitë kryesore të zonave të mbrojtura mjedisore të marra në studim. Plotësimi dhe interpretimi i të dhënave të pyetësorit u bazua tek metodologjia e hartuar për këtë qëllim. Synimi kryesor i anketimit është identifikimi dhe vlerësimi që lidhet me njohjen e problematikave aktuale që shqetësojnë dhe

shoqërojnë ruajtjen, administrimin dhe menaxhimin e ZMM dhe të burimeve të tyre natyrore. Të dhënat e siguruar do të përdoren me synimin për të ndikuar mbi vendimmarrësit, organizatat e ndryshme dhe publikun e gjerë që t'i kushtojnë më shumë vëmendje RrKZMM dhe arritjeve të kriterëve të BE-së në këtë fushë.

Me këtë vlerësim, më pas dhe analizimin e problemeve të shkaktuara, krahas adresimit u synua që të arrihej qëllimi për tërheqjen e vëmendjes publike drejt problematikave kryesore me të cilat përballen sot zonat e mbrojtura mjedisore, rritjen e reagimit ndaj tyre si dhe caktimin e rekomandimeve përkatëse për minimizimin e impakteve negative. Hartografimi i presioneve dhe kërcënimeve ndaj zonave të mbrojtura ekzistuese dhe ekosistemeve të pambrojtura, njëherazi shërben edhe për të identifikuar veprimet emergjente që duhen marrë për kërcënimet ndaj sistemit të zonave të mbrojtura të vendit.

Vlerësimi i gjendjes së Mjedisit Detar në Shqipëri

Tiranë, 26 Shkurt 2018 - Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri në bashkëpunim me Qendrën Rajonale të Mjedisit - REC Shqipëri, në kuadër të programit SENIOR-II, si pjesë e Granteve për Prioritetet Kombëtare, zbatuar nga REC Shqipëri dhe mbështetur nga Qeveria Suedeze (Embassy of Sweden) në Shqipëri, organizuan Konferencën Kombëtare "Vlerësimi i gjendjes së mjedisit detar në Shqipëri".

Konferencën e përshëndeti përfaqësuesi i Qendrës Rajonale të Mjedisit në Shqipëri, z.Eduard Cani, duke nënvizuar se raporti i vlerësimit parashtron një model zhvillimi afatgjatë për hapësirën detare, duke paraqitur rastet pozitive dhe negative të menaxhimit dhe të efekteve të reformave gjatë këtyre viteve. Parashtrori rëndësinë e gjetjeve dhe të rekomandimeve profesionale, të paanshme, të ekuilibruara, gjithëpërfshirëse, mbi mundësitë e përdorimit

të qëndrueshëm dhe rikuperimit të burimeve dhe zbatimit të parimeve të menaxhimit të mjedisit detar, bazuar në menaxhimin e integruar dhe të

qëndrueshëm dhe një plan veprimi lidhur me arritjen e targeteve të OZhQ-14, si dhe promovimin e veprimeve pozitive të vendit në aktivitetet ndërkombëtare në kuadër të OKB-së.

Në konferencë merrnin pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore përgjegjëse si: QNOD, AKZM, AdRZM në rajonet e bregdetit (Shkodër, Divjakë, Vlorë), AKPT, AKBN, AKUK, AZRT; profesorë dhe studentë të UT dhe UB; përfaqësues të UNDP, organizata të shoqërisë civile, etj.

Në këtë takim u prezantua raporti i vlerësimit të gjendjes së mjedisit detar për periudhën

1991-2015, i bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e një grup ekspertësh të fushave që lidhen me mjedisin detar dhe

Vijon në faqe 7



Vijon nga faqe 6 bregdetar. Theksohet që gjetjet dhe rekomandimet janë tepër të rëndësishme për qeverinë, ministritë dhe qeverisjen lokale edhe në kuadër të përmbushjes së angazhimeve kombëtare, për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, që Kombet e Bashkuara kanë shpallur për realizim në nivel global. Ky raport u realizua nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA).



Raporti i vlerësimit të gjendjes së mjedisit detar në Shqipëri është një sintezë e studimeve ku janë prezantuar se si është trajtuar deti, burimet e tij natyrore dhe cila ka qenë mënyra e menaxhimit të tij, si pjesë e mjedisit tonë dhe e axhendës qeveritare gjatë periudhës 1991-2015 në shkallë kombëtare. Përmes grumbullimit, vlerësimit dhe analizimit të të dhënave shkencore, të zhvillimeve sociale, ekonomike, infrastrukturale, turistike, të kuadrit ligjor dhe institucional, raporti paraqet pjesët e një puzzle ku secila figurë është një hallkë e rëndësishme e zinxhirit të menaxhimit të integruar, përdorimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore që përmbajnë në gjirin e tyre hapësirat e detit me bregdetit dhe vlerat natyrore, biodiversitetit, peizazhit, social-ekonomike, turistike dhe historike, kulturore dhe shpirtërore që ofron kjo hapësirë.

Raporti i prezantuar në këtë konferencë ka detajuar ndikimet negative të zhvillimit social-ekonomik dhe dëmtimet në mjedis si rrjedhojë e zbatimit të politikave, programeve dhe planifikimit të përgjithshëm të këtij territori, në nivel kombëtar, lokal dhe rajonal. Njëherazi ka evidencuar qartë dhe me analizë analitike mungesat dhe mundësitë që ofrojnë kuadri ligjor dhe institucional, përdorimi me efektivitet dhe mirëmenaxhimi i sistemit detar-bregdetar për

zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit dhe në mënyrë të veçantë të mjedisit detar. Zhvillimi social-ekonomik, bujqësor, infrastruktura dhe turizmi për vetë shtrirjen dhe përmasat e tyre përbëjnë një rrezik serioz për mjedisin detar. Shtimi në rritje i aktiviteteve njerëzore paraqet një rrezikshmëri të lartë për biodiversitetin, peizazhin dhe për vlerat historike e kulturore, po të mos menaxhohet në mënyrën e duhur, sjellë pasoja negative të pa rikuperueshme.

Në hapësirën bregdetare ka një fluks të madh ndërtimesh një pjesë e konsiderueshme e të cilave bëhen jashtë kontrollit, urbanizimi po bëhet një tjetër faktor dëmtues i peizazhit natyror shqiptar, duke ulur në këtë mënyrë dhe potencialin turistik të tij. Hapësira detare-bregdetare është duke u ndeshur me probleme serioze të shkatërrimit të habitateve, ndotjes së ujërave, erozionit bregdetar dhe humbjes së burimeve natyrore.

Zhvillimi planeve kombëtare, lokale e rajonale të hapësirës detare, të cilat mungojnë, duhet të konsiderohet si ndihmëse në menaxhimin e integruar të hapësirës bregdetare-detare, pa dëmtuar mjedisin e tyre natyror dhe të peizazhit.

Vendosja e kontrollit nga ana e shtetit dhe integrimi i parimeve të ruajtjes së natyrës dhe diversitetit biologjik dhe peizazhor në politikat e planifikimit të territorit duhet të përbëjnë një përparësi për vendin. Në të kundërt pasojat do të jenë të rënda dhe kostoja e menaxhimit e



përballimit të tyre do të jetë mjaft e lartë. Për këtë duhet që ministritë përgjegjëse, të cilat në mjaft raste mjedisin detar e kanë parë vetëm brenda cakut të tyre dhe ka

Vijon në faqe 8

Vijon nga faqe 7 munguar një bashkëveprim dhe koordinim ndërmjet tyre, duhet të ndryshojnë mentalitetet dhe të bashkërendojnë punën dhe



bregdetare, e parë kjo brenda forcimit të partneritet me shoqërinë civile. Kjo strategji duhet të sigurojë rolin drejtues dhe udhërrëfyes të shtetit për të mbështetur implementimin e menaxhimit të integruar të hapësirës detare-bregdetare. Menaxhimi i integruar i kësaj hapësire duhet të mbetet çështje kombëtare. Vetë përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe rajonale shprehën interes për studimin dhe kërkuan një bashkëpunim më të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që të vlerësonin në rutinën e punës së tyre rekomandimet e dhëna, por dhe të përdornin studimet e përmendura në këtë raport si elemente bazë në menaxhimin e zonës detare që ata e kanë pjesë të misioneve të institucioneve që ata përfaqësonin.

politikat në të mirë të zhvillimit të qëdrueshëm. Të pranishmit në këtë event shprehën interesin për zhvillimet që kanë ndodhur në mjedisin detar, që prek vendin tonë dhe ndanë me organizatorët dhe ekspertët që punuan për hartimin e këtij raporti, opinionet dhe rekomandimet e tyre për një menaxhim më të mirë të tij në plotësimin e detyrimeve dhe angazhimeve rajonale dhe globale. Theksuan domosdoshmërinë e unifikimit të legjislatcionit dhe përcaktimin e kompetencave insitucionale në lidhje me këtë hapësirë; një strategji kombëtare e aftë për të nxitur mënyrën e bashkëpunimi, në drejtim të planifikimit dhe menaxhimit të zonës detare-



Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



Fragmente nga manuali i praktikave më të mira botërore

Shteti: Danimarkë

Rasti: Zgjerimi i aeroportit Billund

Theksi: Përfshirja e publikut në vendimmarrje sjell kursime dhe përmirësime shoqërore-mjedisore.

Aeroporti Billund, aeroporti i dytë më i madh në Danimarkë, mori në shqyrtim disa rrugë për zgjerimin e kapacitetit të tij. Për të reduktuar numrin e shtëpive të ekspozuara ndaj zhurmës, plani i zgjerimit përfshinte zgjerimin e një prej pistave në veri. Autoriteti rajonal vendas i mjedisit e përfshiu komunitetin vendas në vendimmarrje, duke i informuar për planin dhe duke kërkuar këshillat e tyre. Bashkëpunimi i

mirë dhe dialogu i vazhdueshëm bëri të mundur diskutimin e alternativave të tjera. U arrit në përfundimin se reduktimi i zhurmës mund të arrihej nëpërmjet ndryshimit të procedurës së ngritjes nga toka në vend të zgjerimit ose ndërtimit të një autostrade të re. Krahas kursimit prej 40,4 milionë eurosh, nga shmangia e ndërtimit u ruajtën afërsisht 350 hektarë tokë bujqësore dhe zonë pyjore. Numri i shtëpive të ekspozuara ndaj zhurmës gjithashtu u reduktua nga 1290 në 328. Kur u krye VNM-ja, nuk pati asnjë ankesë për zhvillimin e propozuar.

Vlerësimi i performancës së energjisë në ndërtesa, Risi e projektit

“Së bashku një sy për mjedisin”

Rrjeti i Vigjilencës mjedisore ka marrë guximin për të trajtuar dhe për të sjellë më afër publikut temën e Eficiencës së Energjisë. Në mënyrë jo rastësore fokusi ka qenë pikërisht kjo temë, duke pasur në vëmendje rëndësinë që ka sektori i energjisë në vendin tonë për disa arsye; Që me protestat për ndërtimin e hidrocentraleve, promovimin e burimeve të tjera të rinovueshme, me angazhimin e qeverisë me miratimin e ligjeve në lidhje me eficientësinë e energjisë apo me performancën e banesave dhe mbi të gjitha me lidhjen që ka ky sektor me përditshmërinë tonë. Shqipëria një vend me klimë mesdhetare karakterizohet dhe nga një dimër i cili shpeshherë është i vështirë për tu përballuar nga qytetarët, si dimri i vitit 2017, apo dhe me ditë shumë të nxehta të cilat përsëri vështirësojnë zhvillimin e aktiviteteve normale jetësore. Organizatat e rrjetit të vigjilencës mjedisore për herë të parë në Shqipëri sollën në mënyrë të prekshme konceptin e Varfërisë Energjetike, duke e trajtuar atë si një përfaqëse për të vlerësuar performancën e energjisë në ndërtesa. Bazuar në një punë 8 mujore, me zhvillimin e një pyetësori të dedikuar në terren, rrjeti grumbulloi në pesë qytete të shqipërisë (Tiranë, Shkodër, Vlorë, Berat, Elbasan) të dhëna për familjet dhe për institucionet publike dhe private në lidhje me tipologjinë e banesave, përdorimin e energjisë elektrike, koston e energjisë elektrike, vlerësimin e aspektit social të jetësës në banesa etj. Varfëria energjetike është një fenomen kompleks që gërshetohet me aspektin social, politik, e energjetik dhe lidh në mënyrë të drejtëpërdrejtë qytetarin me mjedisin.

Të dhënat e grumbulluara paraqiten nëpërmjet raportit “Vlerësimi i performancës së energjisë në ndërtesa përmes konceptit të varfërisë energjetike”. Raporti faktori dhe konkretizon një situatë problematike e jetësore për qytetarët dhe jep të dhëna të cilat janë ndërgjegjësuere

për publikun e gjerë. nga Qendra EDEN Përmes raportit jepet

alarmi për politikëbërësit në sektorin social dhe atë energjetik dhe siguriest që nxitet e ofrohet mundësia për bashkëpunim me organet vendimarrëse.

Raporti i prezantuar është vlerësuar nga ekspertët në takimet e zhvilluara nga Qendra EDEN si një hap i parë dhe i rëndësishëm, i cili në gjerësinë që ka sektori i energjisë, performanca e energjisë në banesa dhe eficientia e energjisë, duhet të merret parasysh dhe të pasurohet më tej me studime e matje të tjera nga ekspertë të

fushës në bashkëpunim me shoqërinë civile.

“Është një nismë shumë e mirë, është një nismë e kohës dhe për tu vlerësuar nga të gjithë! Duhet të forcohet ndërgjegjësimi i qytetarëve për eficientësinë e energjisë, të nxiten sjelljet e qytetarëve që çojnë në uljen e konsumit të energjisë”- ishte një nga disa prej përshtypjeve të marra nga takimet me aktorët e interesit.


Raportin e plotë mund ta lexoni nëpërmjet këtij linku <http://bit.ly/2Fo3MgQ> dhe për raportet e zhvilluara në qytetin e Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Elbasanit dhe Beratit mund të

kontaktoni secilën prej organizatave të rrjetit të vigjilencës mjedisore.

Urojmë që ky studim të jetë vetëm fillimi i punës në fushën e eficientësisë së energjisë, në nxitjen e investimeve nga pushteti vendor dhe hartimin e politikave mbështetëse dhe favorizuese për familjet e vendit tonë.

Falenderojmë çdo aktorë të përfshirë, çdo person apo familje që na ka besuar të dhënat e tij!

Projekti “Së bashku një sy për mjedisin”, nga rrjeti i Vigjilencës mjedisore, drejtuar nga Qendra Mjedisore EDEN, mundësohet financiarisht nga Ambasada Suedeze në Tiranë, nëpërmjet programit SENIOR II zbatuar nga REC Shqipëri





NJOFTIME

- 3 Mars - Dita Botërore e Jetës së Egër
- 5 Mars - Dita Botërore e Eficiencës së Energjisë
- 14 Mars - Dita Ndërkombëtare e Veprimtimit për Lumenjtë
- 21 Mars - Dita Ndërkombëtare e Pyjeve
- 22 Mars - Dita Botërore e Ujit
- 23 Mars - Dita Botërore e Meteorologjisë
- 31 Mars - Ora e Tokës (e shtuna e fundit e Marsit)
- 1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.


Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojmë Arinjtë Shqiptarë"



Organizatat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
Redaksia: Nihat Dragoti; Ilirjan Qirjazi; Vilma Kadiu; Marinela Mitro